



BASHKIA
TIRANË

KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 85, datë 26.07.2017

PËR

“MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA PA KONKURRIM NË FAVOR TË “TIRANA PARKING” TË OBJEKTIT “TRUALL”, ME NR. PASURIE 3/257, VOLUMI 35, FAQE 60 DHE ZK. 8210, SIPËRFAQE TOTALE 7,775 M² NË PRONËSI TË QENDRËS SPORTIVE SH.A, TIRANË”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja (b) dhe pika 1/1.2, nenit 25, nenit 54, shkronja (e), nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar; vendimit nr. 86, datë 03.02.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e së drejtës së pronësisë së shoqërisë “Qendra Sportive” sha, Tiranë, me kapital 100 për qind shtetëror, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, te Bashkia Tiranë”; vendimit nr.54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 22.06.2017 të Këshillit Mbikqyrës të Qendrës Sportive sh.a, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë në parim dhënien me qira pa konkurrim në favor të “Tirana Parking” të objektit truall, me numër pasurie 3/257, volumi 35, faqe 60 dhe ZK. 8210, objektit truall me sipërfaqe totale 7,775 (shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë) m², sipas genplanit bashkëlidhur në pronësi të Qendrës Sportive Sh.a.
2. Afati i dhënies me qira është për 10 vjet.
3. Ky proces të kryhet sipas përcaktimeve të Kreut I, pika 5, shkronja (d) të vendimit nr. 54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.
4. “Tirana Parking” të përdorë pasuritë e mësipërme për ushtrimin e detyrave të saj institucionale dhe funksionale, të përcaktuara sipas akteve nënligjore të krijimit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik dhe Qendra Sportive Sh.a.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI